



Јавна установа
Institucioni publik
Дом на култура "КОЧО РАЦИН"
Shtëpia e kulturës "KOÇO RACIN"
Скопје, Република Северна Македонија
Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Број. Numër 03-167/1
Дата/data 06.07.2026

THIRRJE PUBLIKE

PËR ZGJEDHJEN DHE FORMIMIN E ORKESTRIT QYTETAR TË INSTRUMENTEVE FRYMORE

IP Shtëpia e Kulturës „Koço Racin“-Shkup shpall Thirrje Publike për zgjedhjen dhe formimin e Orkestrit Qytetar të Instrumenteve Frymore, i cili do ta përfaqësojë Qytetin e Shkupit dhe IP Shtëpia e Kulturës „Koço Racin“-Shkup në ngjarje kulturore, artistike, protokollare, festive, koncertale dhe ndërkombëtare, me qëllim zhvillimin, avancimin dhe afirmimin e artit të muzikës për instrumente frymore dhe kulturës muzikore.

1. E DREJTA E PJESËMARRJES

Në këtë thirrje publike mund të aplikojnë:

- institucionet publike dhe private në fushën e kulturës që në veprimtarinë e tyre kanë ansamble ose orkestra frymore;
- shoqatat e qytetarëve që kanë të formuar orkestër frymore;
- akademitë muzikore, fakultetet dhe institucionet e arsimit të lartë në fushën e artit muzikor;
- shkollat e mesme të muzikës;
- shoqëritë kulturo-artistike me orkestër frymore aktive;
- subjekte të tjera juridike të regjistruara sipas ligjit që mund të dëshmojnë punë të vazhdueshme të orkestrit frymor;
- persona fizikë – dirigjentë;
- persona fizikë – interpretues të instrumenteve frymore dhe të perkusionit.

Personat fizikë mund të aplikojnë në mënyrë të pavarur nga subjektet juridike, me qëllim formimin e Orkestrit Qytetar të Instrumenteve Frymore përmes procedurës së përzgjedhjes së dirigjentit dhe interpretuesve.

2. KUSHTET PËR PJESËMARRJE

A) Për orkestra ekzistuese dhe subjekte juridike

Orkestra e paraqitur duhet të plotësojë kushtet minimale:

- të jetë subjekt juridik i regjistruar;
 - të jetë aktive së paku 2 (dy) vite;
 - të ketë të paktën 20 anëtarë aktivë në momentin e aplikimit;
 - të ketë dirigjent të angazhuar me arsim të lartë muzikor ose së paku 5 vite përvojë në drejtimin e orkestrave frymore;
 - të ketë realizuar të paktën 5 paraqitje publike në dy vitet e fundit.
-

B) Për kandidatët – dirigjentë

Kandidati duhet:

- të ketë përfunduar arsim të lartë në fushën e artit muzikor;
 - të ketë së paku 5 vite përvojë në drejtimin e orkestrave, ansambleve ose formacioneve muzikore;
 - të dorëzojë koncept dhe program pune për Orkestrin Qytetar të Instrumenteve Frymore;
 - të ketë aftësi organizative dhe artistike për formimin dhe drejtimin e orkestrit.
-

C) Për kandidatët – interpretues

Kandidatët duhet:

- të posedojnë njohuri dhe aftësi muzikore për instrumentin për të cilin aplikojnë;
 - të jenë të gatshëm të marrin pjesë në audicion, provë ose formë tjetër të verifikimit të aftësive muzikore;
 - të marrin pjesë në aktivitetet e rregullta të orkestrit nëse përzgjidhen;
 - të posedojnë instrumentin e tyre personal, të cilin do ta përdorin në prova dhe paraqitje koncertale.
-

3. PËRBËRJA STANDARDE E ORKESTRIT

Orkestra e përzgjedhur duhet të ketë së paku **23 anëtarë**:

Instrumente frymore druri (9)

- Flaut – 2
- Klarinetë në Bb – 4
- Saksofon alto – 2
- Saksofon tenor – 1

Instrumente frymore metali (10)

- Trompetë – 3

- Horn – 2
- Trombon – 3
- Tuba – 2

Instrumente të perkusionit (3)

- Tambur i vogël – 1
- Tambur i madh / cimbale – 1
- Perkusion shtesë – 1

Udhëheqje

- Dirigjent – 1

Gjithsej: 23 anëtarë (22 interpretues dhe 1 dirigjent)

Orkestra mund të zgjerohet me instrumente shtesë sipas nevojave programore, por nuk mund të ketë më pak se numri minimal i përcaktuar.

4. KUSHT SHITESË

Nëse orkestra në momentin e aplikimit nuk ka përbërje të plotë instrumentale, mund të aplikojë me kusht që të dorëzojë deklaratë me shkrim dhe plan për plotësimin e përbërjes.

Pas përzgjedhjes, orkestra e zgjedhur duhet që brenda 3 (tre) muajve nga nënshkrimi i kontratës të kompletojë përbërjen instrumentale sipas kushteve të thirrjes. Mosplotësimi i këtij kushti përbën bazë për ndërprerjen e kontratës dhe humbjen e statusit të Orkestrit Qytetar Frymor.

5. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Për subjekte juridike:

- aplikim i plotësuar;
- dokument për regjistrim;
- biografia e dirigjentit;
- lista e anëtarëve me instrumentet përkatëse;
- biografi e shkurtër e orkestrit;
- lista e paraqitjeve të realizuara në dy vitet e fundit;
- materiale fotografike, audio, video ose lidhje interneti;
- repertori i orkestrit;
- plan për plotësimin e përbërjes (nëse është e nevojshme).

Për dirigjentë:

- aplikim;
- biografi profesionale;
- dëshmi për arsimim dhe përvojë;
- koncept dhe program pune;
- rekomandime dhe referenca (nëse posedohen).

Për interpretues:

- aplikim;
 - biografi e shkurtër;
 - të dhëna për instrumentin;
 - dëshmi për arsimim dhe përvojë muzikore;
 - materiale audio/video ose lidhje nga paraqitjet (nëse posedohen).
-

6. KRITERET E VLERËSIMIT

Komisioni profesional i formuar nga drejtori i JQ Qendra e Kulturës „Koço Racin“ do t'i vlerësojë aplikimet.

Për subjekte juridike dhe orkestra ekzistuese:

- numri dhe përbërja instrumentale – deri në 30 pikë
- profesionalizmi dhe përvoja e dirigjentit – deri në 20 pikë
- cilësia artistike dhe paraqitjet – deri në 25 pikë
- repertori – deri në 15 pikë
- kapaciteti organizativ – deri në 10 pikë

Maksimumi: 100 pikë

Për dirigjentë:

- arsimimi dhe profesionalizmi – 25 pikë
- përvoja profesionale – 25 pikë
- koncepti i punës – 25 pikë
- aftësitë organizative dhe udhëheqëse – 25 pikë

Maksimumi: 100 pikë

Komisioni mund të kërkojë dokumentacion shtesë, intervistë, audicion ose provë pune.

7. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

Nëse aplikojnë orkestra ekzistuese, bëhet përzgjedhja e një aplikanti më të suksesshëm sipas kriterëve.

Nëse aplikojnë persona fizikë, procedura zhvillohet në dy faza:

Faza e parë:

Komisioni zgjedh një dirigjent për Orkestrin Qytetar Frymor.

Faza e dytë:

Dirigjenti i zgjedhur përzgjedh interpretuesit përmes audicionit, provës ose shqyrtimit të materialeve.

Përbërja përfundimtare e orkestrit formohet nga vendimi i dirigjentit, sipas strukturës së përcaktuar në këtë thirrje.

Dirigjenti është i obliguar të veprojë në përputhje me aktet dhe rregulloret e brendshme të IP Shtëpia e Kulturës „Koço Racin“-Shkup.

8. DETYRIMET E ORKESTRIT

Orkestra e zgjedhur duhet:

- të përfaqësojë Qytetin e Shkupit dhe institucionin në ngjarje zyrtare;
- të marrë pjesë në festa dhe manifestime kulturore;
- të realizojë së paku 10 paraqitje publike në vit;
- të marrë pjesë në festivale vendore dhe ndërkombëtare;
- të mbajë përbërjen dhe cilësinë instrumentale;
- të zhvillojë prova të rregullta;
- të dorëzojë raport vjetor të punës.

Në rast të formimit përmes dirigjentit, ai është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin artistik.

9. DETYRIMET KONTRAKTUALE

Pas përfundimit të procedurës, themeluesi – Qyteti i Shkupit do të lidhë kontratë me IP Shtëpia e Kulturës „Koço Racin“-Shkup për realizimin e programit të Orkestrit Qytetar Frymor.

Do të lidhen marrëveshje me:

- subjektin juridik të zgjedhur, ose
- dirigjentin dhe interpretuesit e përzgjedhur.

Marrëveshjet rregullojnë:

- përbërjen dhe funksionimin e orkestrit;
- aktivitetet dhe paraqitjet;
- pjesëmarrjen në ngjarje;
- provat dhe cilësinë artistike;

- përdorimin e emrit “Orkestra Qytetare Frymore e Qytetit të Shkupit”;
- monitorimin dhe vlerësimin;
- kushtet për ndryshim ose ndërprerje;
- kompensimet financiare;
- çështje të tjera relevante.

10. AFATI I APLIKIMIT

Afati për dorëzimin e aplikimeve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të Thirrjes Publike.

Afati i fundit: 20.07.2026, ora 16:00.

11. MËNYRA E DORËZIMIT

Aplikimet dorëzohen:

- personalisht në arkivin e IP Shtëpia e Kulturës „Koço Racin“-Shkup
- përmes postës: Rr. “Dimitrie Çupovski” nr. 20a, P.F. 173
- në email: dk.kocoracin@gmail.com

Aplikimet e paplota ose të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

12. PUBLIKIMI I REZULTATEVE

Rezultatet e Thirrjes Publike do të publikohen në faqen zyrtare të IP Shtëpia e Kulturës „Koço Racin“-Shkup brenda 10 (dhjetë) ditëve pas përfundimit të afatit të aplikimit.

IP Shtëpia e Kulturës „Koço Racin“-Shkup rezervon të drejtën të mos përzgjedhë asnjë aplikant në rast se asnjë nga aplikimet nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Thirrje Publike.

06/07/2026

Shkup

IP Shtëpia e kulturës Koço Racin Shkup

